

ARTAN R. HOXHA

Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë
artan.r.hoxha@gmail.com

NGA PERIFERIA NË PERIFERI: SHPËRBËRJA E BASHKIMIT SOVJETIK DHE TRANZICIONI PERANDORAK NË SHQIPËRI E BALLKAN**Abstrakt:**

Shembja e Bashkimit Sovjetik dhe rënia e regjimeve komuniste shënon një pikë të rëndësishme kthese në historinë europiane. Me fundin e Luftës së Ftohtë filloi edhe zgjerimi gradual i Bashkimit Europian drejt Lindjes dhe përfshirjen brenda tij të pjesës më të madhe të ish-vendeve komuniste. Europa Lindore, me të cilën kuptohej zona sovjetike e influencës, u shndërrua jo vetëm në një hapësirë të zgjerimit të ndikimit të BE-së, por u përfshi edhe në pjesën më të madhe të kufijve brenda kësaj të fundit. Në këtë kuptim, sikundër ka argumentuar Jan Zielonka, Bashkimi Europian shfaq karakteristikat e një perandorie që prirret të shtrijë kufijtë e tij drejt periferive. Ballkani, e për rrjedhim edhe Shqipëria, si lagje e jashtme e BE-së është kthyer në një zonë ku struktura europiane kërkon të vendosë kontrollin e saj. Zgjerimi i Bashkimit Europian nuk ka vijuar pa pengesa dhe ndikimi i tij po rivalizohet nga aktorë të rinj që duan ta kthejnë Ballkanin në zonën e tyre të influencës - sikundër është rasti i Rosisë dhe i Turqisë. Krahas me këto dinamika, ka ecur paralelisht edhe fundi i parimit vestfalian i sovranitetit kombëtar. Edhe pse ende larg anëtarësimit në BE, Shqipëria vijon të këmbëngulë të bëhet pjesë e klubit europian si dhe është futur pa asnjë ngurrim në globalizmin neoliberal. Këto zhvillime dëshmojnë këputjen e rëndësishme historike që ka kryer Shqipëria e sotme në raport me atë të përpara vitit 1991. Ndryshimet e rëndësishme strukturore në Europë, prekën sa Ballkanin aq edhe Shqipërinë.

Fjalë kyçe:

Bashkimi Europian, Bashkimi Sovjetik, Rusi, Turqi, Shqipëri, antihegjemoni, globalizëm, hegjemoni, imperializëm, komunizëm, Luftë e Ftohtë, neoliberalizëm, perandori.

Hyrje

Rreth dhjetë vjet më parë, një grup muratorësh rusë nisën të ndërtonin murin e lartë që rrethon sot ambasadën e Rusisë në Tiranë. E teksa këta punonin nën diellin përvëlues të verës mesdhetare, i shihje të ndërprisnin punën e të bisedonin me të moshuar shqiptarë që ndërsa kalonin atypari ndalnin për të shkëmbyer me specialistët rusë dy fjalë në gjuhën e Leninit. Dhjetëvjeçarë të tërë i ndanin këta të moshuar nga koha kur, ende fare të rinj, kishin mësuar rusisht gjatë studimeve të tyre në Bashkimin Sovjetik. Qysh nga viti 1961, kur Shqipëria kishte ndërprerë marrëdhëniet me BRSS-në, ata nuk kishin pasur mundësi të flisnin gjuhën e Majakovskit, Gorkit e Shollohovit. Këta burra të shkuar në moshë, të kërrusur, me kapele republike, që sfidonin vapën e tmerrshme të verës në Tiranë ishin reliktet e fundit të gjalla të globalizmit sovjetik, fuqia e të cilit ishte shtrirë deri në brigjet e Adriatikut.

Pensionistët që flisnin rusisht me muratorët rusë më kujtonin radio-gramafonin “Ural”, arkën me pllaka gramafoni me muzikë klasike ruse, librat rusisht – sidomos ata të Leninit – me firmën e gjyshit tim me shkronja cirilike – lojën për fëmijë “Sputnik”, që kremtonte triumfin e shkencës sovjetike në pushtimin e hapësirës. Ishin artefakte, që shënonin një epokë historike që kishte lënë gjurmë edhe brenda mureve të shtëpisë sime. Këto objekte që dikur përfaqësonin hapjen e Shqipërisë me një botë të madhe që shkonte deri në Kamçatka, tanimë preheshin në harresë qosheve të banesës sime, thujse të padukshme e të shpërfillura. Po njëllonj, edhe këta të moshuar që me nostalgji shfrytëzonin rastin për t’u rikthyer në vitet e lavdishme të tyre, ishin gjithçka që mbetej nga ajo kohë kur Bashkimi Sovjetik shërbente si dritarja prej nga ku në Shqipëri depërtonte flladi i modernitetit. E kaluara komuniste identifikohet me ekonominë e komanduar, radhët e gjata, varfërinë e madje edhe korrupsionin.

Sot, tridhjetë vjet pas rënies së komunizmit, Shqipëria është hedhur në një globalizim tjetër, në atë të përqendruar rreth Perëndimit dhe hegjemonisë amerikane dhe BE-së. Pikërisht, rreth dyqind metra larg ambasadës së Rusisë, në anën tjetër të bulevardit “Dëshmorët e Kombit” ngrihet 140 metra drejt qiellit kulla “Tirana Downtown One”, godina më e lartë e kryeqytetit shqiptar. Fasada e saj, ku një dekor ballkonesh krijon hartën e Shqipërisë, është e kthyer drejt veriperëndimit, kah Brukselit –

imazh shumë domethënës ky për orientimin e vendit drejt Bashkimit Europian. Kjo është aspirata e shqiptarëve qysh në vitin 1991, kur kërkonin vendosjen e pluralizmit politik me sloganin “*E duam Shqipërinë si gjithë Europa!*” Shqiptarët nuk ishin të vetmit që udhëhiqeshin nga një qëllim i tillë. Në krejt vendet e Bllokut Socialist, rrezimi i regjimeve sovjetike kishte si lajtmotiv “kthimin në Europë”, “rifutjen në familjen europiane”, atje, në vatrën e përbashkët. Brukseli drejt të cilit fasada e “Downtown One” sheh, nuk është vetëm kryeqendra e teknokratëve të Bashkimit Europian, por edhe selia e NATO-s, e aleancës ushtarake, pjesë e së cilës Shqipëria është qysh prej vitit 2009. “Thirrja e Perëndimit”, mesianizmi i motos “Go West” që u popullarizua nga kënga e famshme me këtë titull e grupit britanik Pet Shop Boys, i përmbledhur në vargjet e saj “*(Go West) This is Our Destiny... (We'll find) promised land*” vijon të ushtojë me gjithë forcën e tij në Shqipëri. Perëndimi vazhdon të përfaqësojë fatin dhe tokën e premtuar.

Kulla më e lartë e Tiranës tregon përmes gjuhës së betonit dhe hekurit se Shqipëria gjendet në një epokë tjetër. Elitat postkomuniste shqiptare kanë braktisur – në mënyrë realiste – çdo lloj forme izolimi kulturor dhe ekonomik nga Perëndimi, si dhe kanë flakur në kosh të plehrave ëndrrat e autarkisë. Nga ana tjetër, Rusia e sotme, i ka kthyer kurrrizin Europës dhe si Shqipëria e Enver Hoxhës dikur, kërkon të lidhet me vendet e botës në zhvillim në Azi e Afrikë për të sfiduar Perëndimin. Muret e ambasadës së Rosisë në Tiranë dhe njerëzit fare të paktë që presin në radhë aty për vizë, tregojnë qartë jo vetëm apelin e papërfillshëm që Rusia ushtron mbi Shqipërinë, por edhe izolimin aktual të Rosisë me vendet që janë pjesëtare të NATO-s. Siç ka thënë edhe një specialist i tranzicioneve postsocialiste në Europën Lindore, Rusia ka ngritur një mur të madh rreth vetes¹ - jo shumë ndryshe nga muri rreth ambasadës së saj, shprehje kjo e mitit të “fortesës së rrethuar”, i cili i artikular qysh në kohën e Bashkimit Sovjetik po ripërdoret nga një Kremlin antihegemon që synon të riformatojë arkitekturën e sistemit ndërkombëtar në atë mënyrë që ta bëjë Rusinë aktore kyçe të fateve të botës.

Nuk është më Shqipëria, por Rusia “the odd one out”, e cila, e trembur nga Perëndimi ka nisur e vetme rrugëtimin drejt sigurisë së

¹ Fyodor Lukyanov, “Russian Foreign and Defense Policy”, në *Russia: Strategy, Policy and Administration*, bot. Irvin Studin (London: Palgrave Macmillan, 2018), 125.

shumëkërkuar. E po njëlloj, mitet e nacionalizmit me përmbajtje të theksuar imperialiste po lulëzojnë në Rusinë e sotme, sikundër është edhe monumenti gjigant i Pjetrit të Madh në brigjet e Moskës. Simbolika e miteve të nacionalizmit rus të fillimit të shek. XXI shpreh edhe kontradiktat e thella identitare që përshkojnë Rusinë e sotme, pasi ato shpërfaqin kundërshtitë ndërmjet euroaziatizmit të deklaruar dhe orientimit të modernizuesve rusë që kanë pasur për pikë referimi Perëndimin - "Tjetri" i domosdoshëm dhe i pashmangshëm që prej tre shekujsh ka ngjallur në radhët e elitave ruse/sovjetike sa frikë aq edhe admirim. Tanimë, vendet janë ndërruar. Në një botë që tashmë shumë e konsiderojnë si postperëndimore, sidomos vende si Rusia, Kina e deri edhe Turqia neotomaniste, Shqipëria e vogël vijon t'i qëndrojë besnike orientimit të saj kah Perëndimit - edhe pse hapësirat për manovrim dhe orientime politike tashmë janë rritur në raport me dy dekada më parë.

Viti 1991 dhe dilemat e Perëndimit

Kur flamuri i kuq me drapër e çekan, i cili ishte valëvitur për 74 vjet mbi Kremlin, u ul më 25 dhjetor të vitit 1991, shënoi edhe aktin simbolik të shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, të formalizuar më 21 dhjetor nga vendimi i republikave që e përbënin atë. Si për ironi të fatit, ishte pikërisht ditën e ringjalljes së Krishtit, më 25 dhjetor, kur flamuri i shtetit të parë komunist dhe i zbatuesit të ateizmit shkencor u ul një herë e përgjithmonë nga vendqëndrimi i tij në godinën e Senatit, në Kremlin, mbrapa mauzoleut të Leninit, themeluesit të eksperimentit sovjetik dhe shtetit të parë të punëtorëve. Po atë ditë, Presidenti amerikan George W. Bush do t'i bënte të ditur bashkëkombësve të tij se me këtë akt kishte përfunduar Lufta e Ftohtë, të cilën SHBA-ja e kishte fituar me ndihmën e Zotit. Në të vërtetë, Lufta e Ftohtë kishte përfunduar dy vjet më parë, kur në dhjetor të vitit 1989 Bush dhe Gorbaçov kishin rënë dakord në Maltë të zëvendësonin marrëveshjen e Jaltës të vitit 1945 me doktrinën e Sinatrës: "*do it your way*". Nga ky moment udhëheqja sovjetike hoqi dorë të impononte vullnetin e saj mbi aleatët europianolindorë.² Më 1 korrik të vitit 1991, vetëm gjashtë muaj përpara se sa flamuri i kuq me drapër e çekan të ulej nga pika më e lartë e Kremlinit, u shpërbë edhe aleanca ushtarake e Paktit të Varshavës, instrumenti përmes së cilës

² Dmitri Trenin, *Post-imperium: A Eurasian Story* (Washington DC: Carnegie Endowment for International Peace, 2011), 4.

Moska ruante kontrollin e saj mbi vendet e Europës Lindore dhe garantonte mbajtjen në pushtet të regjimeve socialiste në këtë pjesë të kontinentit.

Kështu, viti 1991 shënoi njëkohësisht fundin e eksperimentit socialist dhe hegjemonisë sovjetike në rajon. Pa u mbyllur ende ky vit, BRSS-ja u nda në dymbëdhjetë republika. Struktura sovjetike që kishte mbajtur në këmbë perandorinë e dikurshme cariste u rrëzua, ose e thënë sipas fjalëve të historianit ukrainas Sergii Plokhy, u shemb edhe e fundit perandori klasike euro-aziatike.³ Por, sikundër shprehej Marksi, idetë e të cilit sa i dhanë formë shek. XX aq janë edhe pazgjidhmërisht të lidhura me temën që trajton ky studim, “*gjërat nuk janë ashtu si duken*”. Fundi i Bashkimit Sovjetik dhe i sferës së tij të influencës nuk shënoi fundin e perandorive. Shumë shpejt, të tjera perandori do të kërkonin të shtriheshin në hapësirën midis Adriatikut dhe Dnieperit, zgjerim ky që ka krijuar dhe vijon të krijojë tensione. Ndryshe nga sa pohonte plot entuziazëm studiuesi i mirënjohur Francis Fukuyama në vitin 1992, historia nuk ka ndalur ende rrugëtimin e saj drejt destinacionit të saj të vetëm i përbërë nga universalizmi i sintezës së demokracisë liberale me ekonominë e tregut. Tridhjetë vjet pas rënies së Bashkimit Sovjetik teleologjia liberale është përgënjeshtuar në shumë fronte.⁴ Në vazhden e entuziazmit që pasoi fundin e Luftës së Ftohtë, historiani Joseph Rothschild deklaronte se Europa Lindore ishte rikthyer tashmë në diversitet, duke nënkuptuar se njëtrajtshmëria sovjetike e të gjitha vendeve në lindje të Elbës, Vjenës dhe Triestes kishte marrë fund.⁵ Tanimë, uniformiteti i imponuar nga ushtritë sovjetike, ekonomia e planifikuar dhe sundimi i partive komuniste u zëvendësua nga larmia e sistemeve politike e diktuar nga specifikat e përvojave të ndryshme kombëtare.

E vërteta është se blloku i vendeve socialiste nuk ishte edhe aq uniform. Dhe në Ballkanin e mbushur me rebelë dhe heretikë, larmia e

³ Serhii Plokhy, *The Last Empire: The Final Days of the Soviet Union* (New York: Basic Books, 2014), XVIII.

⁴ Francis Fukuyama, *The End of History and the Last Man* (New York: The Free Press, 1992).

⁵ Joseph Rothschild, *Return to Diversity: A Political History of East Central Europe Since World War II* (New York-Oxford: Oxford University Press), 1993.

vendeve socialiste do të ishte më e spikatur se kudo tjetër.⁶ Diversiteti, - shkruan Odd Arne Westad, - ka qenë kryefjala e Luftës së Ftohtë në siujdhesën juglindore të Europës.⁷ Mbi të gjitha, ashtu siç do ta zbulonin shumë shpejt vendet ish-socialiste të Europës Lindore, zyrtarët e Brukselit nuk ishin edhe aq tolerantë ndaj veçorive që impononte historia. Rruga drejt Europës do të ishte e mbushur me tensione që kundërvinin nga njëri krah nevojën për t'u integruar në një strukturë mbikombëtare dhe nga krahu tjetër nacionalizmin, i cili kishte vijuar të mbetej një faktor i rëndësishëm ideologjik edhe gjatë gjysmëshekullit socialist. Dhe në fakt, ky do të ishte edhe tensioni kryesor me të cilin do të ballafaqoheshin të gjitha vendet europiane që dilnin nga sistemi socialist. Pasi ishin çliruar nga dora e rëndë sovjetike, pjesa më e madhe e elitave politike postkomuniste të Europës Lindore zbuluan pavarësinë e vendimmarrjes, të cilën, diktati i Brukselit dhe rregullat e pafundme për integrimin në BE dukej se po e kërconin të trettej sërish.⁸

Viti 1991 përfaqëson një vit të rëndësishëm historik. Në janar filloi me operacionin “Stuhia e Shkretëtirës” në Irak të një koalicioni të drejtuar nga SHBA-ja, ku Bashkimi Sovjetik qëndroi si spektator dhe në dhjetor u mbyll me shembjen e këtij të fundit. Në muajt midis këtyre dy ngjarjeve, paralelisht me shpërbërjen e Paktit të Varshavës, filloi edhe përmbyllja e procesit të formimit të shtetkombeve në pjesën lindore të Europës, që kishte nisur në Versajë, por që gjithsesi nuk ishte çuar deri në fund. Përveç Bashkimit Sovjetik do të shkërmoqej, e shoqëruar nga një luftë e përgjakshme edhe Jugosllavia. Në qershor të vitit 1991, Kroacia dhe Sllovenia shpallën shkëputjen nga Federata Jugosllave. Në shtator do të ndiqeshin nga Maqedonia. Në janar të vitit 1992, Bosnja dhe Hercegovina do të ndiqte shembullin e tri republikave të tjera dhe shumë shpejt do të bëhej arenë e luftërave të përgjakshme ndërmjet nacionalizmave rivalë dhe ekskluzivistë. Nëse bota bipolare e Luftës së Ftohtë i kishte mbajtur fërkimet ndëretnike në Ballkan të ngrira, me

⁶ Theodhora Dragostinova, *The Cold War From the Margins: A Small Socialist State on the Global Cultural Scene* (Ithaca, NY: Cornell University Press, 2021), 62-95.

⁷ Odd Arne Westad, “The Balkans: A Cold War Mystery”, në *The Balkans in the Cold War*, bot. Svtozar Rajak e të tjerë (London: Palgrave Macmillan, 2017), 358.

⁸ Reinhard Heinisch, “Returning to ‘Europe’ and the Rise of Europragmatism: Party Politics and European Union Since 1989”, në *The Routledge History of East Central Europe since 1700*, bot. Irina Livezeanu & Árpád Von Klimó (London & New York: Routledge, 2017), 436.

fundin e saj, konfliktet e vjetra u shkrinë dhe kaluan në fazën e nxehtë të tyre.⁹ Më 1 janar të vitit 1993 do të shpërbëhej edhe Çekosllovakia.

Në një kohë kur pjesa perëndimore e Europës po përjetonte jo vetëm bollëkun e jashtëzakonshëm material, depolitizimin e vazhdueshëm të jetës dhe një rënie gjithnjë e më të madhe të nacionalizmit, aq sa Fukuyama do ta quante Europën si hapësirën më përfaqësuese të njeriut të fundit, pjesa lindore e saj dukej se ziente nga zjarri i *thymos*-it të pasionit politik, e shprehur përmes platformave politike nacionaliste. Ballkani do të ishte ajo pjesë e kontinentit, ku “ballkanizimi” do të çonte në luftëra dhe destabilitet që do të zgjateshin përgjatë gjithë dekadës së fundit të shek. XX. E kështu, gadishulli në juglindje të Europës do të shfaqej si *alter ego*-ja e Europës, e kundërta e saj, zona e padisiplinuar dhe e egër, e mbarsur me urrejtje, armiqësi tribale dhe diktatorë që refuzonin zgjidhjet diplomatike, institucionet demokratike dhe ekonominë e tregut. Ballkani ishte zona e barbarisë në dyert e Europës. Segmente të gjera brenda vendeve të BE-së kërkonin të mbyllnin dyert dhe ta shndërronin unionin në një fortesë muret e së cilës do të ruanin të paprekur Edenin Perëndimor nga barbarët e Lindjes.

Ndërkaq, për arsye sigurie, Gorbaçovi kishte rënë dakord se tërheqja sovjetike nga Europa Lindore nuk do të shoqërohej me një zgjerim të strukturave të Atlantikut të Veriut dhe BE-së. Edhe pse në Maltë, Jalta u braktis, SHBA-ja dhe aleatët e saj perëndimorë zotoheshin ta shtrinin ndikimin e tyre përtej kufirit të përcaktuar në vitin 1945 midis Stalinit, Ruzveltit dhe Çërçillit. *Zwischeneuropa*, pra i gjithë territori ndërmjet kufijve të Gjermanisë dhe Rusisë presupozohej, sipas udhëheqjes sovjetike dhe më pas asaj ruse, si një hapësirë tampon, një tokë e askujt që do të mbante larg cilindo kërcënim që mund t’i vinte BRSS-së ose Rusisë nga Perëndimi.¹⁰ Gjithsesi, historia mori tjetër drejtim.

Shembja e Bashkimit Sovjetik dhe shpërbërja e Paktit të Varshavës krijuan një vakuim pushteti në gjithë hapësirën ish-socialiste. Tensionet etnike dhe nacionalizmi në rritje, si dhe kriza ekonomike që po kalonin vendet e Europës Lindore, detyruan Perëndimin, jashtë vullnetit të tij të formulonte politika të cilat do ta shndërronin atë në arbitrin hegjemon të

⁹ Westad, “The Balkans: A Cold War Mystery”, 361.

¹⁰ Trenin, *Post-imperium*, 25-26 & 32-33.

të gjithë rripit që shtrihej nga Balltiku në Adriatik.¹¹ Nisur nga nevoja për të garantuar sigurinë e saj, BE-ja dhe NATO-ja u shtrinë drejt Lindjes në një proces të shkallëzuar me qëllim që të mbushnin boshllëkun e krijuar nga tërheqja sovjetike. Problematike për vendet e Bashkimit Europian si edhe për Aleancën Ushtarake të Atlantikut të Veriut ishte sidomos Ballkani që ziente nga konfliktet ndëretnike dhe etnonacionalizmi i skajshëm. Opsioni i karantinimit të këtij rajoni nuk ishte i mundur: ishte shumë afër gjeografikisht për t'u shpërfillur. Si rregull, specialistët e sigurisë i kanë cilësuar kufijtë si zona rreziku që mund të kërcënonin sigurinë e qendrave.¹² E njëjta gjë ka vlejtur edhe për Ballkanin. Teknokratët e Brukselit, elitat politike të Europës dhe specialistët e sigurisë së vendeve të NATO-s, e përfytyronin Ballkanin, me ose pa të drejtë, si një hapësirë e mbarsur me konflikte potenciale, e prandaj kontrollin mbi të e cilësonin si mjaft të rëndësishëm. Siguria e Europës ishte në lojë dhe kështu, në Bruksel, grupi që mbështeti përfshirjen e vendeve të siujdhesës brenda BE-së fitoi. Po njëjloj, për arsye të ngjashme Shtetet e Bashkuara mposhtën dilemat dhe vendosën të ndërhyenin në konfliktet që përfshinë siujdhesën në juglindje të Europës duke e shndërruar veten, kështu, në aktoren kryesore për vendosjen e paqes dhe normalizimin e rajonit.¹³

¹¹ Përfaqësues i pesimizmit dhe i pasigurisë që shkaktoi fundi i Luftës së Ftohtë në radhët e mjaft qarqeve politike në SHBA dhe Europë është artikulli i studiuesit amerikan John Mearshaimer në vitin 1990. Në këtë artikull, Mearshaimer parashikonte se fundi i Luftës së Ftohtë do të krijonte një destabilizim të përgjithshëm në krejt Europën dhe luftëra të vazhdueshme, që do të gërryenin çdo themel të hegjemonisë së një superfuqie të vetme në kontinentin e vjetër. John J. Mearsheimer, "Back to the Future: Instability in Europe after the Cold War", *International Security* 15, 1 (1990): 5-56; Shih gjithashtu edhe analizën e Barry Posen-it mbi problemet e sigurisë në Europën e pas Luftës së Ftohtë në kushtet e rritjes së tensioneve etnike. Barry Posen, "The Security Dilemma and Ethnic Conflict", *Survival* 35, 1 (1993): 27-47.

¹² Thomas Christiansen & Knud Erik Jørgensen, "Transnational governance "above" and "below" the state: The changing of borders in the new Europe", *Regional and Federal Studies* 10, 2 (2000): 65.

¹³ Barry Buzan & Ole Wæver, *Regions and Powers: The Structure of International Relations* (Cambridge-New York: Cambridge University Press, 2003), 386-391.

Ballkani dhe Perandoria europiane

Njëloj si SHBA-ja pas Luftës së Dytë Botërore në Europën Perëndimore, edhe BE-ja u shndërrua në një perandori, zgjerimi i së cilës bëhej me vetë ftesën e periferive të saj.¹⁴ Ishin ish-vendet socialiste ato që kërkonin të bëheshin pjesë e klubit europian, e që këmbëngulnin të përfshiheshin në strukturat e mbrojtjes së Atlantikut të Veriut dhe të bëheshin anëtare me të drejta të plota të BE-së. Fundi i Luftës së Ftohtë dhe shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, e bashkë me të edhe pamundësia e Ruisë për të kontrolluar ish-periferinë e saj europiane, e shndërruan BE-në në një perandori të vërtetë. Por, sikundër thotë edhe studiuesi me origjinë polake Jan Zielonka, Bashkimi European shfaq të gjitha cilësitë e një perandorie: një njësi e gjerë territoriale që rrezaton autoritetin e saj ekonomik, politik, diplomatik e ushtarak në shkallë globale, që gëzon kapacitete dhe pushtet të imponojë vullnetin e qendrës së saj mbi një varg aktorësh ndërkombëtarë autonomë. Këta aktorë përbëjnë periferinë e perandorive, mbi të cilët qendrat perandorake ushtrojnë kontrollin e tyre duke e justifikuar mbi bazën e një misioni civilizues.¹⁵ Pra, perandoritë formatojnë periferitë përgjatë kufijve të vet sipas imazhit të tyre.

Por BE-ja nuk është e ngjashme me perandoritë e centralizuara europiane të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX. Bashkimi European, siç thotë edhe Zielonka, nuk shëmbëllen me shtetin modern vestfalian që kërkon të vendosë përmes hegjemonisë së kulturës së elitës drejtuese homogjenitetin kulturor, gjuhësor dhe ku pushteti përqendrohet në duart e strukturës burokratike shtetërore që e përcjell autoritetin nga qendra në periferi. Unioni i përket formës së shtetit postmodern; ai është një perandori policentrike, e decentralizuar, e ngjashme me perandorinë e Karlit të Madh. Njëkohësisht, BE-ja përkrah heterogjenitetin dhe pluralizmin kulturor, që e vlerëson si aset, dhe kundërshton hierarkitë që

¹⁴ Mbi subjektin e “perandorisë së ftuar”, pra të rritjes së ndikimit amerikan në Europën Perëndimore të pasluftës, shih Victoria de Grazia, *Irresistible Empire: America's Advance Through 20th Century Europe* (Cambridge, MA - London: Belknap of Harvard University Press, 2005); Geir Lundestad, *The United States and Western Europe since 1945: From Empire by “Invitation” to Transatlantic Drift* (Oxford: Oxford University Press, 2003).

¹⁵ Jan Zielonka, “Empires and the Modern International System”, *Geopolitics* 17, 3 (2012): 507-509.

prodhon hegjemonia e një grupi apo kombësie. Në fakt, gjysma e parë e shek. XX dhe dy Luftërat Botërore, treguan çmimin dhe pamundësinë e një projekti të tillë. Bashkimi European nuk është një perandori që zgjerohet në mënyrë të njëanshme nga një qendër që kërkon tregje dhe lëndë të parë. Shqetësimi konstant i elitave europiane është ruajtja e kompetivitetit ekonomik, sidomos brenda tregut të përbashkët, ruajtja e mirëqenies së shoqërive të tyre dhe sigurimi i kufijve.

E pikërisht këtu, në zonën periferike, përgjatë kufijve fluidë të saj shfaqet edhe një tipar tjetër i rëndësishëm i kësaj perandorie. Me zgjerimin e saj të vazhdueshëm, BE-ja nuk e konceptoi më kufirin si një mur që ngrinte një digë të pakapërcyeshme midis “Nesh” dhe të “Tjerëve”, një hendek që ndante në mënyrë të prerë Europën nga hapësira që shtrihet përtej saj. Kështu, nga metafora e Europës si fortesë, pas rënies së socializmit dhe shtrirjes së saj drejt Lindjes, shohim të vlejë metafora tjetër e Europës si labirint. Në periferinë e saj, aty ku ndodh edhe shtyrja e kufijve, vihet në lëvizje një mekanizëm kompleks i cili jo vetëm thjesht përjashton - edhe pse ky proces ndodh - por edhe përfshin, ndërthur, ngërthen, mpleks ndikime, tradita dhe përvoja historike të ndryshme brenda një ngrehine të unifikuar institucionale.¹⁶

Është pikërisht në vendet në periferinë e saj, të cilat kërkojnë të integrohen brenda strukturave të unionit ku BE-ja ushtron hegjemoninë e saj përmes diktimit pa kompromis të institucioneve të saj politike dhe ekonomike. Teknokratët e Brukselit, si agjentë të vërtetë të misionit civilizues, që merr emrin e dekomunistimizimit dhe europianizimit, monitorojnë ndërtimin e institucioneve europiane në vendet kandidatë dhe u vendosin atyre nota, sikur të ishin nxënës të shkollës fillore. Europianizimi është një term politik, kulturor e identitar kyç i një ideologjie të tërë që ka për aks të drejtat e njeriut, tregun e lirë, institucionet e demokracisë liberale, dhe multikulturalizmin. Krijimi i projektit european dhe më pas zgjerimi i kufijve të Europës është kryer nën flamurin e këtij boshti aksiologjik. Vendet e periferisë së BE-së, të cilat të gjitha aspirojnë të futen në klubin e privilegjuar të kombeve europiane gëzojnë një sovranitet të kufizuar përballë unionit - jo shumë

¹⁶ Christiansen & Jørgensen, “Transnational governance “above” and “below” the state”, 74-76; Jan Zielonka, “Introduction: Boundary making by the European Union”, në *Europe Unbound: Enlarging and reshaping the boundaries of the European Union*, bot. Jan Zielonka (London & New York: Routledge, 2002), 13.

ndryshe edhe si vendet anëtare - dhe janë të varura ekonomikisht e politikisht në mënyrë të pazgjidhshme me vendet e BE-së.¹⁷

Nga ky moment, me zgjerimin e strukturave euroatlantike brenda asaj që prej vitit 1945 deri në vitin 1990 kishte qenë parcela sovjetike nis të shfaqet edhe një ontologji e re gjeografike dhe rajonale. Fundi i komunizmit, shpërbërja e Bashkimit Sovjetik si dhe dinamikat e ndryshme dhe kronologjia e procesit të integritimit në BE dhe anëtarësimit në NATO nxori në pah larushinë e përvojave historike të vendeve dhe shoqërive të asaj që deri në vitin 1990 ishte quajtur në mënyrë të thjeshtëzuar si Europë Lindore.¹⁸ Europa Lindore tashmë u shty edhe më në Lindje, në republikat ortodokse të ish-BRSS, duke ndjekur kështu një aks perëndim-lindje që përputhej me vijat ndarëse ndërmjet katolicizmit e protestantizmit me ortodoksinë. Një ndarje tjetër po aq e rëndësishme ishte ajo përgjatë boshtit jug-veri, pak a shumë me kufi Danubin, ndërmjet rajoneve të dominuara nga Perandoria Osmane, apo që edhe përpara saj kishin qenë brenda universit bizantin ortodoks dhe hapësirës katolike që i përkiste trashëgimisë habsburgase - të quajtur ndryshe vendet e Vishegradit, ku përfshihen Hungaria, Çekia, Sllovakia dhe Polonia. Në ontologjinë gjeografike të pas Luftës së Ftohtë, ky diferencim u emërtua përkatësisht si Europë Juglindore dhe Europë Qendrore Lindore. Këto dallime nuk i përgjigjen vetëm përvojave të ndryshme historike dhe strukturave shoqërore dhe ekonomike.

Emrat, si produkt i pushtetit tregojnë shumë për qëllimet dhe objektivat e atyre që i vendosin ata. Kjo duket veçanërisht në rastin e Ballkanit, i cili në kuadrin e transformimeve që pasuan fundin e Luftës së Ftohtë, shembjen e Bashkimit Sovjetik, integrimin dhe orientimin politik, kulturor dhe ekonomik të vendeve të këtij rajoni brenda strukturave të Bashkimit Europian, nis e quhet Europë Juglindore. E thënë ndryshe,

¹⁷ Jan Zielonka, *Europe as Empire: The Nature of the Enlarged European Union* (Oxford: Oxford University Press, 2007); Zielonka, "Empires and the Modern International System", 502-525; Shih edhe James Caporaso, "The European Union and the Forms of State: Westphalian, Regulatory or Post-Modern?", *Journal of Common Market Studies* 34, 1 (1996): 29-52; John Gerard Ruggie, "Territoriality and Beyond: Problematizing Modernity in International Relations", *International Organization* 47, 1 (1993): 139-174.

¹⁸ Klaus Buchenau, "From Foreign Intervention to European Integration: Southeastern Europe since 1989", në *The Routledge Handbook of Balkan and Southeast European History*, bot. John R. Lampe & Ulf Brunnbauer (London-New York: Routledge, 2021), 524.

ndryshimi i emërimit reflekton kalimin e rajonit nga një hapësirë liminale jo edhe aq europiane në një pjesë të Europës.¹⁹ Nga emri osman, Ballkan, që do të thotë mal, kalohet në Europë, e shoqëruar me mbiemrin gjeografik juglindore. Vendosija e këtij mbiemri nuk është edhe aq i pafajshëm dhe nuk lidhet thjesht me skrupujt teknokratikë dhe për hir të precizionit të vendndodhjes gjeografike. Po aq sa emërtimi Europë Qendrore Lindore nënkupton se vendet e Vishegradit janë të shkëputura nga ndikimi dhe sfera e influencës së Moskës, duke delegjitimuar kështu mëtimet e Ruisë postsovjetike për ta trajtuar këtë pjesë të kontinentit si një zonë tampon mes saj dhe Perëndimit.

Po në të njëjtën mënyrë, emërtimi i Ballkanit si Europë Juglindore do të thotë njëkohësisht se Brukseli sa nuk njeh pretendimet ruse se siujdhesa është një lagje e jashtme e saj ku ka interesa të jetë e pranishme, aq edhe shkëput rajonin nga e kaluara e tij osmane. Në mënyrë të tërthortë, por gjithsesi të qartë, ky emërtim ua mbyll dyert përprjekjeve të Turqisë për ta parë rajonin si një parcelë të vetën me të drejta historike për të ushtruar aty ndikimin e saj si mbrojtëse dhe kujdestare e popullsisive myslimane. Kështu, kalimi nga Ballkani në Europën Juglindore i normalizon vendet e kësaj hapësire. Duke i emërtuar si pjesë të Europës Juglindore, shoqëritë e siujdhesës cilësohen si europiane dhe e ardhmja e tyre në BE bëhet e qartë, edhe pse perspektiva e integritit të tyre mbetet ende e mjegullt, sidomos për vendet e Ballkanit Perëndimor, ku vetë prania e emrit “Ballkan” tregon qartë mosshkëputjen e tyre të plotë nga e shkuara dhe gjendjen liminale të këtyre vendeve. Historia vijon të peshojë mbi Shqipërinë, Serbinë, Maqedoninë e Veriut, Bosnjë-Hercegovinën dhe Malin e Zi. BE-ja nuk i cilëson ato ende plotësisht europiane.

Kategoritë e reja në ontologjinë gjeografiko-rajonale të Europës, që zgjerojnë kufijtë e saj politikë dhe krijojnë parcela ku Brukseli ngul flamurin e kontrollit të tij, dëshmojnë edhe një vizion të qartë se ku mbaron BE-ja. Bashkë me kufijtë e unionit krijohet edhe “Tjetri”, që nuk është më komunizmi, Bashkimi Sovjetik. “Tjetri” tanimë formulohet në diskursin universalist të Luftës së Ftohtë që kundërvinte binjakët demokraci liberale-kapitalizëm me demokraci popullore-ekonomi e

¹⁹ Mbi procesin e kalimit të rajoneve europiane të Perandorisë Osmane nga Ballkani në Europë Juglindore, shih John R. Lampe, *Balkans Into Southeastern Europe: A Century of War and Transition* (New York: Palgrave Macmillan, 2006).

planifikuar. Në epokën e pas Luftës së Ftohtë, në një botë që po bëhet gjithnjë e më shumë shumëpolshe, dikotomia ndërmjet “Ne” dhe “Ata” artikullohet në terma kulturorë, civilizues që shërbejnë si kritere që përcaktojnë se kush integrohet e kush përjashtohet.²⁰ Në vizionin e teknokratëve dhe elitave politike të BE-së, Europa mbaron në kufijtë e Turqisë dhe Ruisë. Janë këto dy vende që sot shërbejnë si “Tjetri” i Europës, që lihen jashtë saj e që në shkallë të ndryshme kërkojnë të ruajnë ndikimin e tyre në lagjet e jashtme të ish-perandorive të tyre, sidomos në Ballkan.²¹ Këtu, BE-ja konkurron për ndikim me këto dy aktore të fuqishme, të cilave së fundmi u është shtuar edhe Kina. Në lagjen ballkanike të Europës, sidomos në ato vende që janë me sytë e drejtuar nga Brukseli për pranim, të tjerë aktorë janë shfaqur në horizont, të gatshëm të hapin dyert e tyre dhe ftojnë të përjashtuarit të gjejnë prehje e mbrojtje brenda gardheve të tjera.

Ballkani Perëndimor si hapësirë e rivalitetit perandorak

Kalimi i Ballkanit në Europën Juglindore nuk ka qenë i thjeshtë, pa pengesa dhe as i pakundërshtuar nga forca e aktorë të tjerë të vendosur jashtë rajonit. Pavarësisht qëllimeve të Gorbaçovit, i cili përmes programit të tij politik “Mendimi i ri”, që synonte të kapërcente dallimet midis Lindjes dhe Perëndimit dhe aspironte të krijonte një Europë e cila do të ishte shtëpia e përbashkët e të gjithë popujve të saj, rezultatet e këtij kursi qenë krejt të ndryshme nga ato që synonte udhëheqësi i fundit sovjetik. Perestrojka dhe Gllasnosti nxitën edhe nacionalizmin e kombësive të ndryshme dhe partizanët e tij filluan të shfaqnin hapur kërkesën e tyre për shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, të cilin nisën ta konsideronin si të fundit perandori që mbijetonte ende në epokën e

²⁰ Mbi shpikjen e Europës dhe procesin e dyfishtë të përfshirjes dhe përjashtimit, shih William Wallace, “Where does Europe End? Dilemmas of inclusion and exclusion”, *Europe Unbound*, 78-94. Shih sidomos faqen 82.

²¹ Mbi rolin e identitetit në politikën e jashtme të BE-së, Ruisë dhe Turqisë dhe procesit të dyfishtë të përfshirjes dhe përjashtimit, shih Tom Casier, “Identities and Images of Competition in the overlapping Neighbourhoods: How EU and Russian Foreign Policy Interact”, në *Security in Shared Neighbourhoods: Foreign Policy of Russia, Turkey and the EU*, bot. Rémi Piet & Licina Simão (Hounsmill, Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2016), 13-34; Maria Raquele Freire, “Russian Foreign Policy and the Shaping of a ‘Greater Europe’”, *po aty*, 35-52; Çiğdem Üstün, “Turkey’s Policies in Its Overlapping Neighbourhood with Russia and the European Union”, *po aty*, 53-74.

“dekolonizimit”.²² Ata që u zhgënjyen nga shembja e BRSS-së ishin nacionalistët rusë, sidomos kur panë se si shkëputja e ish-republikave sovjetike u shoqërua me një prirje për t’i kthyer kurrizin Ruisë e për të parë drejt hegjemonit të kohës, superfuqisë së vetme në këmbë, SHBA-së. Si rezultat, ndodhi ajo që kishte parashikuar edhe Henri Kissinger në momentin kur ngrehina sovjetike po shembej. Ish-Sekretari i Shtetit kishte parashikuar se në Rusi me shumë gjasa do të zhvilloheshin prirje politike revanshiste që do të kërkonin rikthimin e perandorisë.²³

Shprehja më kuptimplotë e këtij revanshizmi është deklarata e Vladimir Putinit në vitin 2005, i cili e cilësoi shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik si katastrofën më të madhe gjeopolitike të shek. XX. Këtu nuk është vendi të analizohet dështimi i Ruisë për t’u integruar në rendin liberal të përqendruar rreth Perëndimit; as edhe mund të flitet gjerësisht mbi triumfin në Moskë të rrymës antiperëndimore neo-sllavofile, që kërkon një rrugë modernizimi origjinale ruse dhe krijimin e një rendi ndërkombëtar shumëpolësh.²⁴ Ajo që ka rëndësi të theksohet është se Ballkani ka qenë që në vitet ’90 një nga arenat kryesore ku Rusia është përpjekur të ushtrojë të drejtën e saj si lojtare në politikën e madhe. Lufta në ish-Jugosllavi i dha elitës postsovjetike ruse mundësinë të ndërhynte në favor të Serbisë, të cilën Moska e quan si motrën e saj të vogël.

Ligjërimi i afërsisë kulturore ruso-serbe, u bë tejet familjar në vitet që pasuan fundin e Luftës së Ftohtë, aq sa shtynë Samuel Huntington-in ta përfshinte atë gjerësisht në librin e tij të famshëm “Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror”, ku studiuesi amerikan argumentonte se tashmë bota kishte kaluar nga përplasja ndërmjet

²² Andrei P. Tsyganov, *Russia’s Foreign Policy: Change and Continuity in National Identity* (Plymouth: Rowman & Littlefield, 2010), 48; Shih edhe Philip G. Roeder, “The Triumph of Nation-States: Lessons from the Collapse of the Soviet Union, Yugoslavia, and Czechoslovakia”, në *After the Collapse of Communism: Comparative Lessons from Transition*, bot. Michael McFaul & Kathryn Stoner-Weiss (New York: Cambridge University Press, 2004), 21-57.

²³ Trenin, *Post-imperium*, 8.

²⁴ Për më shumë mbi politikën e jashtme ruse pas rënies së Bashkimit Sovjetik dhe sindromën perandorake, shih Barbara Fernandes, “Putin’s Foreign Policy Towards Europe: Evolving Trends of an (Un)Avoidable Relationship”, në *Shifting Priorities in Russia’s Foreign and Security Policy*, bot. Roger E. Kanet & Rémi Piet, Farnham & Burlington, Ashgate (2014), 13-34; Bobo Lo, *Russian Foreign Policy in the Post-Soviet Era: Reality, Illusion and Mythmaking* (Houndsmill, Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2002), 1-97.

ideologjive shekullore universaliste në konfrontimin ndërmjet civilizimeve ekskluziviste.²⁵ Përtej ndjeshmërisë pansllaviste, këmbëngulja ruse për të mbrojtur Serbinë ishte gjithashtu rezultat i vijimësisë së mendësisë së Luftës së Ftohtë dhe përlllogaritjeve gjeopolitike që mbështeteshin mbi të drejtën që krerët e Moskës mendonin se u takonte për të qenë arbitër i fateve të një rajoni që ajo e konsideronte si një parcelë të sajën. Siç edhe rrëfen në kujtimet e tij zëvendëssekretari i Shtetit gjatë administratës së Klintonit si dhe këshilltari special i Sekretarit të Shtetit mbi ish-republikat Sovjetike, Strobe Talbot, këtë zgjerim të interesit dhe përfshirjes amerikane në një rajon që kishte qenë historikisht jashtë interesave të Uashingtonit, elita politike ruse e konsideroi si shkelje të një ndër parimeve bazë të diplomacisë amerikane për të mos ndërhyrë brenda hapësirave që cilësoheshin si pjesë të sferës së ndikimit sovjetik.²⁶

Diplomacia postsovjetike ruse e perceptoi ndërhyrjen ushtarake të Perëndimit në Ballkan dhe shndërrimin e SHBA-së dhe BE-së në autoritetet që përcaktonin fatet e rajonit në periudhën postsocialiste si një kërcënim të drejtpërdrejtë për Rusinë.²⁷ Edhe pse BRSS-ja ishte shembur, diplomacia ruse vijonte ta shihte botën të ndarë në vija ndarëse imagjinare dhe parcela ku Moska kërkonte t'i njihej nga të tjerët roli i policit. Kjo ambicie e udhëheqjes postsovjetike ruse shkaktoi jo pak shqetësime në vendet ballkanike - me përjashtim të Serbisë - madje edhe në radhët e ish-aleatëve besnikë, sikundër ishte rasti i Bullgarisë.²⁸ Ideologët dhe drejtuesit e Rusisë së sotme në kundërvënien ndaj fuqisë

²⁵ Samuel P. Huntington, *The Clash of Civilizations and the Remaking of the World Order* (New York: Simon & Schuster, 1996), 126-127, 138, 260-262, 269-270, 280-291, 294-296.

²⁶ Strobe Talbot, *The Russia Hand: a Memoir of Presidential Diplomacy* (New York: Random House, 2003), 77-78.

²⁷ Christian Thorun, *Explaining Change in Russian Foreign Policy: The Role of Ideas in Post-Soviet Russia's Conduct Towards the West* (Hounsmill, Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2009), 81-110; Alexei Arbatov, "The Transformation of Russia's Military Doctrine in the Aftermath of Kosovo and Chechnya", në *Russia Between East and West*, bot. Gabriel Gorodetsky (London - Portland, OR: Frank Cass, 2005), 27-31; Margot Light, John Löwenhardt & Stephen White, "Russia and the Dual Expansion of Europe", *po aty*, 56-69.

²⁸ Diana Bozhilova, "Bulgaria", në *National Perspectives on Russia: European foreign policy in the making?*, bot. Maxine David, Jackie Gower & Hiski Haukkala (New York: Routledge, 2013), 189.

globale amerikane e kanë ngritur tanimë multipolaritetin në statusin e një ligji të natyrës.²⁹ Ata e shohin po aq të natyrshme që në botën e shek. XXI, Rusia të ketë bahçen e saj ku të ushtrojë funksionin e xhandarit dhe brenda gardhit të saj nuk lejon asnjë fuqi tjetër të ndërhyjë.

Për t'ia arritur këtij qëllimi, Kremlini po ndërhyt me vendosmëri gjithnjë e më të madhe në periferitë juglindore të Europës. Përmes investimeve ekonomike, shitjes së armatimeve dhe bashkëpunimit ushtarak, por edhe duke përdorur klientët e saj me qëllim destabilizimin e situatës politike, Moska prej vitesh rreket të faktorizojë veten dhe të përdorë ndikimin e saj në rajon me qëllim për t'iu imponuar BE-së. Kjo është veçanërisht e dukshme në Ballkanin Perëndimor, vendet e të cilat vijojnë të mos jenë anëtare të BE-së. Jeta politike në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, është e ndarë në mbështetës të Moskës - kryesisht përkrahësit e modelit autoritar të qeverisjes - dhe të Bashkimit European dhe NATO-s. Madje, përçapjet e Moskës kanë filluar të kenë sukses edhe në Shqipëri, ku e djathta, nisur nga interesat e lidërshpimit të saj, po artikulon gjithnjë e më shumë një ligjërim antiamerikan.

Edhe pse jo si Rusia që është vetëshpallur si kundërshtar e hapur e rendit ekzistues dhe rendit ndërkombëtar të përqendruar rreth Perëndimit, Turqia, e cila është anëtare e NATO-s, përfaqëson "Tjetrin" në kufijtë e BE-së, kufirin ku mbaron Europa. Por nuk është vetëm Bashkimi European që përjashton Turqinë. Dekadat e fundit, nën flamurin e neootomanizmit edhe kjo e fundit e ka përjashtuar gradualisht Europën. Në vend ta shohë veten si një periferi të kontinentit të vjetër, Turqia po e percepton veten gjithnjë e më shumë si një fuqi rajonale, trashëgimtare e një perandorie që shtrihej në tri kontinente. Shembja e Bashkimit Sovjetik shënoi një moment të rëndësishëm për Turqinë që kjo të shkëputej dukshëm nga postulati qemalist që kërkonte shkëputjen përfundimtare të turqve nga fantazma e nostalgjisë për perandorinë e humbur. Fundi i Luftës së Ftohtë hapi perspektiva shumë të mëdha për Turqinë që kjo të shtrinte ndikimin e saj në Ballkan dhe Azinë Qendrore, dy rajone këto të cilat për sa kohë BRSS-ja ishte në këmbë, përfaqësonin një mollë të ndaluar për këdo që ishte në krye të Ankarasë.

²⁹ Lev N. Klepatskii, "The New Russia and the New World Order", në *Russia Between East and West*, 6.

Këto ndryshime në politikën e jashtme turke, përfaqësonin një transformim të qenësishëm në perceptimin e vetes që ndodhi në radhët e elitave politike turke në këtë moment kritik historik. Kjo pasqyrohet edhe në refuzimin që neootomanistët i bëjnë metaforës së urës midis Lindjes dhe Perëndimit, e hapësirës kalimtare. Në vend që ta shohin veten si bishti i BE-së, ata aspirojnë të jenë një qendër që luan rol hegjemon në ish-zotërimet europiane të Portës së Lartë. Ndërsa përjashton ndryshimin e kufijve, Ankaraja kërkon të shtrijë ndikimin e saj dhe të krijojë një sferë interesi ku ajo të jetë aktore e privilegjuar. Vizioni neootomanist që po udhëheq lidhshpimin turk, i farkëtuar në kontekstin kulturor postmodernist dhe që gjen shprehje në infrastrukturën e globalizmit neoliberal, po e shndërron Turqinë gjithnjë e më shumë në një fuqi antihegjemone. Ankaraja po përplaslet gjithnjë e më shumë me BE-në dhe aleatët e saj të NATO-s, përfshi këtu edhe ambicien e së parës për të zgjeruar sferën e ndikimit të saj në vendet e Ballkanit Perëndimor. Për të arritur këtë qëllim, Turqia përdor sa investimet në sektorët strategjikë ekonomikë aq edhe ngritjen e një rrjeti të dendur qendrash kulturore, shkollash e universitetesh, sponsorizimet bujare për bashkësitë fetare myslimane e deri te bombardimi me telenovela turke, tashmë të kudoshikuara në krejt hapësirën ndërmjet Adriatikut dhe Detit të Zi.³⁰

Tridhjetë vjet pas mbarimit të Luftës së Ftohtë dhe eliminimit të kufijve që mbanin Europën të ndarë e të ngrirë në dy fushime kundërshtare ideologjike, Ballkani - sidomos pjesa perëndimore e tij - është sërish një arenë ku, sikurse ishte përpara Luftës së Dytë Botërore, garojnë për ndikim fuqi të mëdha. Me shfaqjen e aktorëve të rinj e të vjetër ndërkombëtarë, Bashkimi Europian nuk është më e vetmja qendër perandorake që kërkon të kontrollojë Ballkanin. Siujdhesa juglindore

³⁰ Igor Torbakov, *After Empire: Nationalist Imagination and Symbolic Politics in Russia and Eurasia in the Twentieth and Twenty-First Century* (Stuttgart: Verlag, 2018), 147-170; Marc Herzog, "Balkan Discourses of the European "Other": Turkey's Foreign Policy in South-Eastern Europe Under the Justice and Development Party", në *Balkan Heritages: Negotiating History and Culture*, bot. Maria Couroucli & Tschavdar Marinov (London & New York: Routledge, 2016), 189-208; Üstün, "Turkey's Policies in Its Overlapping Neighbourhood with Russia and the European Union", 53-74; Cengiz Candar & Graham E. Fuller, "Grand Geopolitics for a New Turkey", *Mediterranean Quarterly* 12, 1 (2000): 22-38; Şener Aktürk, "Incompatible Visions of Supra-Nationalism: National Identity in Turkey and the European Union", *European Journal of Sociology/Archives Européennes de Sociologie* 48, 2 (2007): 347-372.

europiane vijon të jetë një hapësirë e kontestuar ku aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë me ambicie perandorake rivalizojnë për hegjemoni, jo shumë ndryshe nga ajo që ndodhte në shek. XIX dhe gjysmës së parë të shek. XX.³¹ Në dekadat e para të shek. XX, BE-ja fut brenda ombrellës së saj vendet e periferisë juglindore që të mbajë larg saj qendra rivale. Këto të fundit përpiqen ta shtrijnë autoritetin e tyre përmes sistemit të klientelave dhe kooptimit të elitave politike lokale apo nëpërmjet ideologjive që justifikojnë krijimin e sferave të influencës - siç është pansllavizmi dhe ortodoksia apo islami dhe neootomanizmi. Si një kryqëzim i madh ndikimesh, ku ambiciet e poleve të ndryshme të rendit ndërkombëtar ndeshen, siujdhesa juglindore e Europës vijon të jetë një periferi e lakmuar nga qendrat e ndryshme perandorake. Sikundër thonë John Lampe dhe Ulf Brunnbauer, shtetet e Europës Juglindore vazhdojnë të jenë si dikur, kur ishin pjesë e Ballkanit, njësi politike që nuk kanë plotësisht në dorë fatin e tyre e që rrethohen nga interesa që nuk janë domosdoshmërisht të tyre.³² Shembja e Bashkimit Sovjetik e shkriu këtë hapësirë në një zonë ku rivaliteti është bërë emëruesi kryesor i periudhës postsocialiste.

Në vend të epilogut: Ideja e Europës e formuluar nga Shqipëria

Si ka ndikuar ky ndryshim kolosal i koniunkturës ndërkombëtare te vetë Shqipëria? Aspirata europiane dhe vlerat që përfaqëson dhe promovon BE-ja, të ndërthurura me ndikimet e poleve të tjera që kërkojnë ta shohin Shqipërinë si pjesë të privilegjuar interesash kanë lënë gjurmën e tyre të pashlyeshme mbi vendin në periudhën postsocialiste. Në të vërtetë, Shqipëria është një kryqëzim i vërtetë influencash dhe sintezash kulturore, qytetërimesh, politike dhe historike. Sot, në epokën e globalizmit e gjithë bota është një kryqëzim i madh, ku globalja ndërthuret e gërshetohet me lokalen duke sendërtuar atë që rëndom quhet

³¹ Mbi format e administrimit të Ballkanit nga Fuqitë e Mëdha europiane në shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, shih Friedrich Kratchowil, "On Systems, Boundaries, and Territoriality: An Inquiry on the Formation of the State System", *World Politics* 39, 1 (1986): 38 & 44.

³² John R. Lampe & Ulf Brunnbauer, "Southeastern Europe after the Cold War", në *Routledge Handbook of Balkan and Southeast European History*, 512.

glocalizim, pra shkrirja e të përgjithshmes me të veçantën.³³ Në këtë pikë, Shqipëria nuk përbën asnjë ndryshim. Ajo nuk është më një dukuri ekzotike, një ishull i shkëputur nga bota që kërkonte të zhbënte pëlhurën perandorake osmane dhe të tirrte në tezgjahun e shtetit-komb një qilim të ri homogjen, të ndryshëm nga pjesa tjetër e botës. Tanimë, e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja krijojnë një amalgamë të jashtëzakonshme ku dominon shumëllojshmëria dhe hapja ndaj botës. Në vend të ballkanizimit kulturor dhe politik, refuzimit të universales në emër të kombëtares, shohim të ndodhë një sintezë ku dimensionimi i hapësirës dhe kohës nuk janë në marrëdhënie përjashtuese. Rajonalizimi etnocentrik është braktisur tashmë në Shqipëri dhe specifikja ka marrë formë kozmopolitane.³⁴

Si një zonë kufitare e BE-së, Shqipëria është një zonë liminale, një hapësirë e zgjerimit dhe ndikimit perandorak europian, që përfshihet brenda labirintit të BE-së. Ky proces ka shprishur përfundimisht parimin vestfalian të homogjenitetit kulturor të kombit dhe konsiderimin e shtetit-komb si një kuti të mbyllur me botën, që kërkon të krijojë njëtrajtësi të brendshme dhe diferencim me atë që ndodhet jashtë kufijve. Modeli modern që kishte udhëhequr gjatë periudhës komuniste elitat e PKSH-së në projektin e shtetndërtimit është zëvendësuar tashmë nga multi-kulturalizmi globalist e postmodern që nxit heterogjenitetin dhe bashkëjetesën e regjimeve të ndryshme kulturore që nuk përjashtojnë njëri-tjetrin. Tri dekada pas rrëzimit të komunizmit, Shqipëria është shndërruar në një pikë lidhjeje mes kulturash dhe përvojash të ndryshme historike që i mbivendosen njëra-tjetrës. Duke nisur nga viti 1991, kufijtë kanë reshtur së qeni vija lineare që e copëtojnë territorin në mënyrë dydimensionale mbi bazën e një konceptimi dikotomik që “fut brenda”

³³ Roland Robertson, “Glocalization: Time-Space and Homogeneity-Heterogeneity”, në *Global Modernities*, bot. Mike Featherstone, Scott Lash dhe Roland Robertson (London: Sage, 1995), 25-44.

³⁴ Mbi konceptet e “rajonalizmit etnik” dhe “rajonalizmit kozmopolitan”, shih Christian Giordano, “Ethnic versus Cosmopolitan Regionalism? For a Political Anthropology of Local Identity Constructions in a Globalized World-System”, në *Region, Regional Identity and Regionalism in Southeastern Europe*, bot. Klaus Roth & Ulf Brunnbauer (Berlin: Lit, 2007), 43-58.

dhe “lë jashtë”. Prej disa dekadash kufiri i epokës moderne është zëvendësuar nga rrjete të dendura ndërshkëmbimesh.³⁵

Këtë transformim e tregon edhe peizazhi urban i Tiranës, ku sheh bashkekzistencën dhe shkëmbimin e prirjeve të ndryshme që nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Fundi i komunizmit shënoi futjen e Shqipërisë në periudhën postmoderne, të epistemës së re të decentralizuar që zëvendëson homogjenitetin dhe regjimentimin e monokulturës me larminë, që fidanishten e sistemuar sipas vizionit shtetëror - të marr këtu si shembull metaforën e përdorur nga James Scott - e zëvendëson me pyllin e harlisur.³⁶ Nga viti 1991, Shqipëria u rrokullis tutje në kohëra e hedhur si hobe nga modeli vestfalian i shtetit, që e ndan territorin në enklava ku vepron dhe ushtron monopolin e pushtetit një autoritet i vetëm, në modelin e labirintit postmodern të Bashkimit European. Edhe pse e mbetur jashtë, ende e përjashtuar nga BE-ja, kjo e fundit projekton mbi Shqipërinë modelin e saj, model që nuk shfaqet vetëm te viabiliteti i institucioneve demokratike dhe funksionimi i mekanizmave të tregut të lirë. Ndërsa Shqipëria ende çalon në këto dy pika, ajo ka përparuar shumë në përqafimin e multikulturalizmit dhe hapjes me botën. Në rritjen gjithnjë e më të madhe të pluralizmin kulturor të Shqipërisë ka ndihmuar edhe futja e aktorëve të tjerë ndërkombëtarë që rivalizojnë për ndikim edhe në këtë qoshe të Ballkanit Perëndimor.

Nëpërmjet perspektivës së zgjerimit, BE-ja ka ndikuar në mënyrë thelbësore në mënyrën se si Shqipëria dhe vendet e tjera të Europës Juglindore kanë rikonceptuar parimin e sovranitetit. Të vendosura në kufijtë porozë të Bashkimit European, e diktuar nga nevoja për t’u integruar në BE, vendet e kësaj periferie janë bërë po ashtu poroze, të hapura, që po formësohen gradualisht sipas modelit që ofron ende lojtari kryesor në rajon. Ky proces përparon pandalshëm edhe në kushtet kur shtete si Shqipëria vijon të mbetet jashtë klubit të privilegjuar european. Premtimi i ëndrrës europiane, e shoqëruar me alternativa të tjera qendrash që kërkojnë të ushtrojnë ndikimin e tyre, e ka shndërruar Ballkanin në një kryqëzim të dominuar nga larmia, shumë e ndryshme tashmë nga sa ka qenë 30 vjet më parë. Kjo është mjaft e dukshme edhe në Shqipëri. E

³⁵ Charles Maiers, “Does Europe need a frontier? From territorial to redistributive community”, *Europe Unbound*, 17-37; Shih edhe Pierre Hassner, “Fixed borders or moving borderlands? A new type of border for a new type of entity”, *po aty*, 38-50.

³⁶ James C. Scott, *Seeing Like a State: How Certain Schemes to Improve Human Condition Have Failed* (New Haven & London: Yale University Press, 1998), 11-22.

vendosur në hapësirën gri të kufirit, si brenda ashtu edhe jashtë, vendi tanimë ka arritur të ketë një porozitet të hapësirës që përpara vitit 1991 nuk e njihnte dhe që elita komuniste e refuzonte. BE-ja *po e modelon* sot këtë periferi të sajën, ashtu si dikur perandoritë e tjera kanë bërë përpara saj.

Sot, Shqipëria, ashtu si edhe vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, është një fushë forcash ku veprojnë vektorë të ndryshëm, një arenë ku përballen aspirata të ndryshme perandorake që depërtojnë, modelojnë, përfshijnë dhe përjashtojnë. Sa pranë aq edhe larg: kjo vijon të jetë historia e këtyre trevave periferike, kësaj hapësire ku bashkëjetojnë përbri njëra-tjetrës ndikime të shumta të së sotmes që përzihen me gjurmët e shumta të së kaluarës. Pikërisht kjo atmosferë pasqyrohet edhe në pyllin e harlisur të peizazhit kaotik urban të Tiranës. Në këtë kuptim, Shqipëria, ashtu si edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, është mjaft e ngjashme me kufirin mesjetar: një zonë gjithnjë e më heterogjene ku, teksa zhbëhet njëtrajtshmëria e imponuar që nga themelimi i shteteve kombëtare mbivendosen ndikime që vijnë nga qendrat e ndryshme të pushtetit.

Në Shqipëri, në këtë kufi të Europës politike, shohim të artikulohet dhe riartikulohet vetë ideja e Europës, si një përfytyrim subjektiv i materializuar në nivelin praktik dhe atë emocional. Shpikja e Europës dhe përforcimi i idesë që ajo përfaqëson, nuk është një proces që thuret e shpërndahet vetëm nga Brukseli, por tirret edhe në zonat liminale si Shqipëria, që mbeten edhe *jo* edhe *po*, edhe *brenda* edhe *jashtë*. E teksa shpik Europën dhe formulon idenë e saj, elitat politike dhe vetë shoqëria shqiptare janë duke rishpikur idenë e kombit duke e përfytyruar atë nën një mënyrë të re, të ndryshme nga ajo që dominonte përpara vitit 1991.³⁷ Ajo shprehet sa në simbolet shekullare aq edhe fetare që mbushin Tiranën dhe qytetet e tjera të Shqipërisë, nga kënga e hoxhallarëve te kabanat e kishave, qofshin ortodokse apo katolike, imazhe dhe tinguj që të kujtojnë përshkrimet e para të Bajronit dy shekuj më parë. Elitat politike shqiptare përdorin heteroegenitetin si kapital politik për t'ia shitur Brukselit me qëllim për të lehtësuar integrimin në BE. I gjithë ky ligjërëm i derdhur në gur e beton, i shoqëruar me falje drejtuar në gjuhë të ndryshme zotave të

³⁷ Mbi “shpikjen” e kombit shih *The Invention of Tradition*, bot. Eric Hobsbawm & Terence Ranger (Cambridge: Cambridge University Press, 1983). Mbi kombin si “bashkësi e përfytyruar”, shih Benedict Anderson, *Imagined Communities: Reflection on the Origin and Spread of Nationalism* (London-New York: Verso, 2006).

feve monoteiste apo me deklarata të këmbënguljes për t'iu bashkuar familjes europiane, synon të zhbëjë imazhin e alienit, barbarit në dyert e qytetit të shenjtë. Në vend të tij del një subjekt shqiptar apo ballkanas që me pasurinë e tij përfaqëson një aset të rëndësishëm për Europën, e prandaj kjo e fundit nuk ka pse të trembet prej tyre. Në vend të kundërvënies me Azinë apo formave konceptuale përjashtuese, ideja e Europës po artikullohet gjithnjë e më shumë përmes sintezave e lidhjeve.

Vitet 1989-1991, që nisën me rënien e murit të Berlinit dhe përfunduan me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, përfaqësojnë një këputje tejet të rëndësishme historike edhe për Shqipërinë. Nuk është më sovraniteti dhe homogjeniteti kombëtar, por integrimi në strukturat perandorake dhe në rrjetin global ekonomik, ajo që elitat postkomuniste të Shqipërisë së vogël vlerësojnë si çelësin e suksesit. Pas traumës së izolimit enverist dhe dështimit spektakolar të eksperimentit për autarki ekonomike, hapja me botën ishte i vetmi opsion. Në Rusinë e madhe postsovjetike shohim se pas viteve '90, një dekadë kjo e mbushur me drama, varfëri dhe dilema, ndodhi e kundërta. Sovraniteti kombëtar dhe izolimi nga Perëndimi, vetëpërjashtimi nga rregullat dominuese të lojës dhe përpjekjet e pandërprera për t'i prishur ato e kanë shndërruar Moskën në një *pariah* ndërkombëtare apo gogolin e rendit të sotëm global. Trajektoret e ndryshme në kushtet e globalizmit të shek. XX në një vend periferik postperandorak dhe një ish-qendre të madhe perandorake me ambicie për t'u ringjallur nga hiri i shkatërrimit dhe për të zënë atë që udhëheqësit e saj mendojnë se është vendi që i takon në botë, dëshmojnë edhe ndryshimin e përjetimeve të përvojave transformuese historike në vendet e vogla dhe të mëdha, atyre që kërkojnë ndihmë dhe atyre që duan të kenë vasalë në botë. Fasada e "Downtown Tirana One" e kthyer nga Brukseli dhe monumenti gjigant i Pjetrit të Madh përgjatë brigjeve të Moskës nuk janë gjë tjetër veçse simbole të reagimit ndaj ngjarjeve të vitit 1991 - nga njëra anë e qasjes jodikotomike të marrëdhënies ndërmjet globales dhe lokales dhe nga ana tjetër e konceptimit të polarizuar, që kundërvë civilizimin global (të keq) me kulturën kombëtare (të mirë).

Bibliografi:

- After the Collapse of Communism: Comparative Lessons from Transition.* Botuar nga Michael McFaul & Kathryn Stoner-Weiss. New York: Cambridge University Press, 2004.
- Aktürk, Şener. "Incompatible Visions of Supra-Nationalism: National Identity in Turkey and the European Union". *European Journal of Sociology/Archives Européennes de Sociologie* 48, 2 (2007): 347-372.
- Anderson, Benedict. *Imagined Communities: Reflection on the Origin and Spread of Nationalism.* London-New York: Verso, 2006.
- Balkan Heritages: Negotiating History and Culture.* Botuar nga Maria Couroucli & Tschavdar Marinov. London & New York: Routledge, 2016.
- Buzan, Barry & Ole Wæver. *Regions and Powers: The Structure of International Relations.* Cambridge-New York: Cambridge University Press, 2003.
- Candar, Cengiz & Graham E. Fuller. "Grand Geopolitics for a New Turkey". *Mediterranean Quarterly* 12, 1 (2000): 22-38.
- Caporaso, James. "The European Union and the Forms of State: Westphalian, Regulatory or Post-Modern?". *Journal of Common Market Studies* 34, 1 (1996): 29-52.
- Christiansen, Thomas & Knud Erik Jørgensen. "Transnational governance "above" and "below" the state: The changing of borders in the new Europe". *Regional and Federal Studies* 10, 2 (2000): 62-77.
- De Grazia, Victoria. *Irresistible Empire: America's Advance Through 20th Century Europe.* Cambridge, MA - London: Belknap of Harvard University Press, 2005.
- Dragostinova, Theodhora. *The Cold War From the Margins: A Small Socialist State on the Global Cultural Scene.* Ithaca, NY: Cornell University Press, 2021.
- Europe Unbound: Enlarging and reshaping the boundaries of the European Union.* Botuar nga Jan Zielonka. London & New York: Routledge, 2002.
- Fukuyama, Francis. *The End of History and the Last Man.* New York: The Free Press, 1992.
- Huntington, Samuel P. *The Clash of Civilizations and the Remaking of the World Order.* New York: Simon & Schuster, 1996.

- Kratchowil, Friedrich. "On Systems, Boundaries, and Territoriality: An Inquiry on the Formation of the State System", *World Politics* 39, 1 (1986): 27-52.
- Lampe, John R. *Balkans Into Southeastern Europe: A Century of War and Transition*. New York: Palgrave Macmillan, 2006.
- Lo, Bobo. *Russian Foreign Policy in the Post-Soviet Era: Reality, Illusion and Mythmaking*. Houndsmill, Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2002.
- Lundestad, Geir. *The United States and Western Europe since 1945: From Empire by "Invitation" to Transatlantic Drift*. Oxford: Oxford University Press, 2003.
- Mearsheimer, John J. "Back to the Future: Instability in Europe after the Cold War". *International Security* 15, 1 (1990): 5-56.
- National Perspectives on Russia: European foreign policy in the making?* Botuar nga Maxine David, Jackie Gower & Hiski Haukkala. New York: Routledge, 2013.
- Polkhy, Serhii. *The Last Empire: The Final Days of the Soviet Union*. New York: Basic Books, 2014.
- Posen, Barry. "The Security Dilemma and Ethnic Conflict". *Survival* 35, 1 (1993): 27-47.
- Region, Regional Identity and Regionalism in Southeastern Europe*. Botuar nga Klaus Roth & Ulf Brunnbauer, Berlin: Lit, 2007.
- Rothschild, Joseph. *Return to Diversity: A Political History of East Central Europe Since World War II*. New York-Oxford: Oxford University Press, 1993.
- Ruggie, John Gerard. "Territoriality and Beyond: Problematizing Modernity in International Relations". *International Organization* 47, 1 (1993): 139-174.
- Russia Between East and West*. Botuar Gabriel Gorodetsky. London - Portland, OR: Frank Cass, 2005.
- Russia: Strategy, Policy and Administration*. Botuar nga Irvin Studin. London: Palgrave Macmillan, 2018.
- Security in Shared Neighbourhoods: Foreign Policy of Russia, Turkey and the EU*. Botuar nga Rémi Piet & Licina Simão. Hounsmill, Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2016.
- Scott, James C. *Seeing Like a State: How Certain Schemes to Improve Human Condition Have Failed*. Nju Haven & London: Yale University Press, 1998.
- Shifting Priorities in Russia's Foreign and Security Policy*. Botuar nga Roger E. Kanet & Rémi Piet. Farnham & Burlington. Ashgate, 2014.

- Talbott, Strobe. *The Russia Hand: a Memoir of Presidential Diplomacy*. New York: Random House, 2003.
- The Balkans in the Cold War*. Botuar nga Svtozar Rajak e të tjerë. London: Palgrave Macmillan, 2017
- The Invention of Tradition*. Botuar nga Eric Hobsbawm & Terence Ranger. Cambridge: Cambridge University Press, 1983.
- The Routledge Handbook of Balkan and Southeast European History*. Botuar nga John R. Lampe & Ulf Brunnbauer. London-New York: Routledge, 2021.
- The Routledge History of East Central Europe since 1700*. Botuar nga Irina Livezeanu & Árpád Von Klimó. London & New York: Routledge, 2017.
- Thorun, Christian. *Explaining Change in Russian Foreign Policy: The Role of Ideas in Post-Soviet Russia's Conduct Towards the West*. Hounsmill, Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2009.
- Torbakov, Igor. *After Empire: Nationalist Imagination and Symbolic Politics in Russia and Eurasia in the Twentieth and Twenty-First Century*. Stuttgart: Verlag, 2018.
- Trenin, Dmitri. *Post-imperium: A Eurasian Story*. Washington DC: Carnegie Endowment for International Peace, 2011.
- Tsyganov, Andrei P. *Russia's Foreign Policy: Change and Continuity in National Identity*. Plymouth: Rowman & Littlefield, 2010.
- Zielonka, Jan. "Empires and the Modern International System", *Geopolitics* 17, 3 (2012): 502-525.
- Zielonka, Jan. *Europe as Empire: The Nature of the Enlarged European Union*. Oxford: Oxford University Press, 2007.

ARTAN R. HOXHA

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
artan.r.hoxha@gmail.com

S u m m a r y

FROM PERIPHERY TO PERIPHERY: THE DISSOLUTION OF THE SOVIET UNION
AND THE IMPERIAL TRANSITION IN ALBANIA AND THE BALKANS

Focusing on Albania, this paper argues that the post-Cold War era Balkans remain a space of imperial expansion and a hot spot of influences from different centers. In the 1990s, the EU expanded without much difficulty. Following the definition of Jan Zielonka concerning the European Union,

which according to the Polish scholar is a new form of empire that expands by invitation and tries to bring under its control and order the outer neighborhoods of the western core, the last decade of the 20th century that coincided with the starkest socio-economic crises of the post-communist years, the EU was an unrivaled force along its eastern and southeastern frontier. However, by the early 21st century the situation changed significantly and Brussels faced new competitors in one of the most problematic regions, the Balkans. Long-standing national hatreds and unquenched rivalry had pushed local actors to pull in their conflicts the great powers, quite often using and manipulating the latter to their petty advantages. Still a peripheral and borderland, the southeastern peninsula of Europe is an arena where the interests of the EU clash with those of a resurgent, revanchist, and anti-hegemonic Russia and of a neo-Ottomanist Turkey that seeks to carve an alternative niche of hers in the Balkans. As regards to Albania, independently of their programs, all the political parties had shown staunch support for the EU and the inclusion of the country within the greater European framework. This is a significant rupture with the history of the country and marks the transformation of the political, economic, cultural, and ideological orientation of the country toward both the West and the changed mindset toward empires. Born out of the ashes of the Ottoman Empire, Albanian nationalism has been profoundly anti-imperialist, a feature it showed both during the interwar era and during the Cold War years. Preserving and reinforcing the country's independence and sovereignty was the paramount task, which both Zog and Hoxha truly believed and made their utmost to defend. At the closing of the 20th century and the triumph of neoliberal globalization, the country's political elite, aware that national sovereignty could not be the central imperative of their policy gradually changed their approach. This was reflected as well in the nationalist discourse, which once reinvented, did not show hostility toward European integration but rather saw it as a destination. As a result, what can be discerned is not a new stance toward empires and an acceptance of imperialism but rather a selective process that accepts the EU, the "empire of good" that expands through invitation exactly for the benefits of modernity it offers to the societies that are included within its borders.